

Financat Vendore për periudhën Janar - Qershor 2024


Miratimi i Ligjit nr.68, datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, e ka çuar procesin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor në një fazë të re konsolidimi. Për të ndjekur këtë proces, Ministria e Financave analizon në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor, me qëllim monitorimin dhe asistencën e njësisve të vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e këtij procesi. Referuar të dhënave të treguesve fiskalë të konsoliduar për 6 mujorin 2024, si dhe të dhënave të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë, është realizuar analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve 6 mujore të buxhetit vendor në nivel kombëtar.

Të ardhurat vendore

Për 6 mujorin e vitit 2024, njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVQV) në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura tatimore në masën 20,833 milionë lekë, shifër kjo që është rreth 5.471 milionë lekë më shumë ose rreth 36 përqind më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2023, ku rritja reflektohet në të gjithë zërat e të ardhurave, kurse Të ardhurat jotatimore të mbledhura nga pushteti vendor në 6 mujorin e parë të vitit 2024 janë rreth 2,089 milionë lekë me rreth 617 milionë lekë më shumë se 6 mujori i vitit të kaluar.

Referuar ecurisë së realizimit të të ardhurave tatimore deri në fund të 6 mujorit 2024, konstatohet që pushteti vendor ka realizuar rreth 72% të planit vjetor të të ardhurave nga burimet e veta, e specifikisht është realizuar me rreth 80 % plani i taksës së pasurisë dhe rreth 69% plani i taksave lokale krahasuar me planin vjetor 2024.

Grafiku 1: Të ardhurat e përgjithshme tatimore të pushtetit vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre në vite




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Ndër vite, të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të tyre. Të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për 6 mujorin e parë të vitit nga *taksat lokale*, janë ato që zënë pjesën më të madhe ose 77.8% të shumës totale të këtyre të ardhurave për 6 mujorin e vitit 2024. Nga ana tjetër nga *taksa e pasurisë* (ndërtesa, trualli dhe toka bujqësore) janë mbledhur rreth 4.574 milionë lekë apo rreth 22% e totalit të të ardhurave vendore. Kurse taksa mbi biznesin e vogël ka ardhur duke u zvogëluar pas ndryshimeve fiskale

ligjore në vetëm 0.2% të peshës së të ardhurave për 6 mujorin 2024. Grafiki këtu ndryshime strukturore të të ardhurave vendore paraqiten si më poshtë:

Grafiku 2: Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit në vite




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Taksat Lokale

Nga të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore peshën më të madhe e zënë taksat lokale, duke qenë kështu burimet më të rëndësishme të financimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga të ardhurat e veta, të cilat gjithmonë e më shumë po konsolidohen në këndvështimin financiar dhe këtë e dëshmon rritja e të ardhurave nga ky burim nga viti në vit. Për 6 mujorin 2024 këto taksa zënë rreth 77.8% të shumës totale të të ardhurave tatimore të pushtetit vendor. Të ardhurat nga taksat lokale kanë konsoliduar trendin në rritje nga viti në vit pas reformës administrativo-territoriale, megjithatë për 6 mujorin e vitit 2024 këto taksa janë mbledhur në vlerën rreth 16.2 miliard lekë, shifër kjo që është rreth 4.198 milionë lekë më shumë ose rreth 35% më e lartë se vlera e mbledhur gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2023. Në këtë drejtim, pushteti vendor ka rritjen më të lartë në mbledhjen e disa taksave dhe tarifave vendore, kryesisht “taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, rritja e të cilës në 6M 2024 është rreth 3,190 milionë lekë më shumë se 6M 2023, si edhe “tarifat e pastrimit dhe higjenës” rritja e të cilave në 6M 2024 është rreth 945 milionë lekë më shumë se 6M 2023. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë për periudhën 6 mujore në vite, për taksat lokale në tërësi grafikisht do të kemi rezultatet si më poshtë:

Grafiku 3: Të ardhurat nga taksat lokale dhe ritmi i ndryshimit të tyre në vite




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Taksa e pasurisë

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të pushtetit vendor. Kjo taksë është një burim mjaft i rëndësishëm vendor përmes së cilës njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të zhvillojnë politika vendore në diskrecion të plotë të përdorimit. Për 6 mujorin e vitit 2024, grupi i taksave mbi pasurinë ku përfshihet, ndërtesa, trualli, toka bujqësore dhe transaksioni i pasurisë zënë rreth 22 % të totalit të të ardhurave të veta tatimore të pushtetit vendor. Në vlerë absolute, nga taksat mbi pasurinë janë mbledhur rreth 4.5 miliardë lekë, shifër kjo që është rreth 1.260 milion lekë ose rreth 38% më e lartë se vlera e mbledhur gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2023. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë, nëse marrim në analizë 6 mujorin në vite do të kemi rezultatet si në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 4: Të ardhurat e pushtetit vendor nga taksa e pasurisë dhe ritmi i ndryshimit të tyre në vite



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Taksa e Biznesit të vogël

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël pas ndryshimeve fiskale ligjore është bërë zero (ligji nr.112/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”). Kjo lehtësi fiskale që u miratua nga buxheti qendror iu kompensua pushtetit vendor në rritjen e transfertave nga qeveria qendrore. Nga realizimi faktik gjatë 6 mujorit të vitit 2024, rezulton se nga ky zë janë mbledhur vetëm 46 milion lekë, që zënë vetëm 0.2% të të ardhurave vendore në 6 mujorin 2024, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonesë rreth 42% më i lartë krahasuar me një vit mëparë. Disa nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mbledhin detyrime nga ky burim për ato subjekte të cilat nuk kanë kryer pagesat brenda afatit dhe rezultojnë debitorë.


Shpenzimet vendore

Shpenzimet e pushtetit vendor kanë një kontribut të rëndësishëm në mirëqënien e qytetarëve, e si rrjedhim ato paraqesin tendenca zhvillimore të ekonomisë në tërësi. Objektivi kryesor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rritjen e peshës së shpenzimeve të pushtetit vendor në raport me shpenzimet e përgjithshme apo ndaj produktit të brendshëm bruto, përbën një tregues të rëndësishëm për vlerësimin e ecurisë pozitive të reformave në menaxhimin financiar në nivel vendor në drejtim të thellimit të decentralizimit fiskal.

Ndër vite shpenzimet e qeverisjes vendore evidentohen si një tregues financiar në rritje të qëndrueshme. Kjo rritje vjen si pasojë e përmirësimit të nivelit të shërbimeve apo funksioneve që qeverisja vendore ofron për qytetarët, të financuara këto si nëpërmjet mbështetjes financiare nga qeveria qendrore në formën e transfertave, po ashtu edhe nëpërmjet rritjes së të ardhurave të veta vendore. Rritja e kompetencave, hapësirës territoriale në administrim dhe sigurisht numrit të banorëve të një bashkie ka bërë që tashmë ato të rrisin përgjegjësinë, transparencën e konsultimin publik, si dhe llogaridhënien në përdorimin e financave publike vendore.

Buxheti vendor për 6 mujorin e parë të vitit 2024, nga të dhënat faktike të thesarit rezulton të jetë realizuar në masën rreth 31 miliardë lekë, ose rreth 2 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë me një rritje prej 7.1%.


Grafiku 5: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre në vite



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet e pushtetit vendor në vite sipas strukturës nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha, por vihet re një tendencë pozitive rritje e qëndrueshmërisë së shpenzimeve të personelit, dhe zgjerimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes së aseteve që njësitë vendore zotërojnë përmes përdorimit në formën e shpenzimeve operative. Nga analiza e të dhënave vihet re që të gjithë zërat e shpenzimeve korente kanë rritje, por pjesën më të madhe të kësaj rritjeje të shpenzimeve vendore krahasuar me 6 mujorin e një viti më parë, e kanë shpenzimet e personelit, një trend rritës ndjekin edhe shpenzimet operative dhe të tjera ndërkohë që shpenzimet kapitale paraqesin një realimin më të ulët se 6 mujori i vitit paraardhës, siç konstatohet edhe nga grafiku më poshtë:

Grafiku 6: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës buxhetore



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 6 mujorit të vitit 2024 dhe 6 mujorit të vitit 2023:

Tabela 1: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës (në milion lekë)

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 6 mujori		Diferenca	
		2024	2023	2024 ndaj 2023 në vlerë	2024 ndaj 2023 në %
I.	Të ardhura nga Pushteti vendor	20,833	15,362	5,471	136%
I.1	Taksa mbi pasurinë	4,574	3,314	1,260	138%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	46	33	13	140%
I.3	Taksat Lokale	16,213	12,015	4,198	135%
II.	Shpenzime nga Pushtetit Vendor	30,999	28,957	2,042	107%
II.1	Shpenzime Korente	25,453	22,780	2,673	112%
	Personeli	15,882	14,040	1,842	113%
	Shpenzime Oper. Mirmbajtje	7,984	7,729	255	103%
	Subvencione	280	221	58	126%
	Te tjera	1,308	790	518	166%
II.2	Shpenzime Kapitale	5,546	6,177	-631	90%

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet e personelit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njësive të veqeverisjes vendore me rreth 51.2%. Për 6 mujorin e vitit 2024 këto shpenzime janë realizuar në masën 15.9 miliard lekë ose rreth 1.8 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Rritja e këtyre shpenzimeve për vitin 2024, vjen si rrjedhojë kryesisht nga rritja e pagave, politikë e ndërmarrë nga qeveria një vit më parë.

Shpenzimet operative që janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve. Këto shpenzime në 6 mujorin 2024 përbëjnë rreth 25.8% të shpenzimevetë pushtetit vendor në total dhe janë realizuar në rreth 8 miliard lekë ose rreth 255 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023.

Shpenzimet për subvencione dhe të tjera janë shpenzimet që zhvillojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Këto shpenzime për 6 mujorin e vitit 2024 janë realizuar në 280 milionë lekë duke u rritur me 58 milion lekë ose 26% për zërin subvencione në raport me 6 mujorin e parë të vitit 2023. Ndërkohë që shpenzimet e tjera korente janë realizuar në masën rreth 1.308 milion lekë ose rreth 518 milion lekë apo 66% më shumë se 6 mujori i parë i vitit 2023.

Shpenzimet Kapitale janë një zë mjaft i rëndësishëm në buxhetin vendor, për shkak sepse këto shpenzime sjellin në mënyrë direkte dhe indirekte zhvillim ekonomik dhe për rrjedhojë ndikojnë mirëqënien e qytetarëve. Për 6 mujorin e parë të vitit 2024 shpenzimet kapitalë zënë rreth 18% të shpenzimeve vendore dhe janë realizuar afërsisht në masën 5.5 miliard lekë ose rreth 631 milion lekë apo 10% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, megjithatë pritshmëria deri në fund të vitit është që ecuria e investimeve të pushtetit vendor të jetë pozitive.

Fondi i rindërtimit që njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përdorur për rimëkëmbjen pas tërmetit është një pjesë tjetër e shpenzimeve që i kalon buxhetit vendor. Financimi për NJVQV-të në vitin 2024 (çelur deri në fund të 6 mujorit, ku përfshihet edhe mbartja e fondit të akorduar me VKM, por e papërdorur në vitin 2023), është rreth 7.5 miliard lekë, ndërkohë që përdorimi i tij për pushtetin vendor deri në fund të 6 mujorit 2024 është rreth 2.3 miliard lekë. Shpenzimet e fondit të rindërtimit paraqiten më të detajuara të ndarë sipas zërave buxhetorë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Shpenzimet e fondit të rindërtimit akorduar për pushtetin vendor sipas natyrës (në milion lekë)

E M Ë R T I M I	Buxheti total 6-mujor	Fakt 6 mujori
	2024	
Fondi i Rindërtimit	7,474	2,357
<i>Shpenzime kapitale</i>	4,902	1,728
<i>Shpenzime operative e mirëmbajtjeje</i>	148	0
<i>Transferta për familjet dhe individët</i>	2,425	629

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)